



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI

Vlorë, më 15.05.2023

Lënda: Ftesë për Negociatë, "Për prodhimin dhe transmetimin e 1 (një) reklame televizive promovuese të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë".

ORGANEVE TË MASMEDIAS/TELEVIZIONEVE

Në zbatim dhe mbështetje të nenit 7 pika 1/b, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të pikës 9 të Vendimit Nr.1195, datë 05.08.2008, të Këshillit të Ministrave "Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetim nga Operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e Administratës Shtetërore", vendimit të SA nr.8, datë 20.02.2023, vendimit të BA nr.3, datë 23.02.2023, të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, shkresës me Nr.945 datë 08.05.2023 "Mbi realizimin e reklamës televizive promovuese të UV-së", si dhe Urdhrit të Administratorit Nr.945/1 prot., Nr.51 datë 09.05.2023 "Për ngritje komisioni për realizimin e reklamës televizive promovuese të UV-së".

Ju dërgon këtë ftesë për pjesëmarrje për prodhimin dhe transmetimin e 1 (një) reklame televizive promovuese të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

OBJEKTI: "Prodhimi dhe transmetimi i 1 (një) reklame televizive promovuese të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë

Periudha e realizimit: 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

Fondi limit i përcaktuar: Fondi limit i procedurës është në vlerën 689,998 (gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

Afati përfundimtar: Për paraqitjen e konfirmimeve nga Media, Organe të Masmedias/televizioneve, është më datë: 19/05/2023, ora 12:00.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI**

Konfirmimet për vazhdimin e negociatave: Konfirmimet duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jo transparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Drejtuar: Komisionit të ndjekjes së procedurave për programe/reklama/spote televizive. Dhe shënimin tjetër: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës 19/05/2023, ora 12:00. Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura. Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni zarfat pranë Sekretarisë Qendrore dhe Protokollit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si më poshtë:

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Adresa: L. Pavarësia, Rruga Kosova

9400, Vlorë, Shqipëri

Adresa e Internetit: info@univlora.edu.al

Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt: "Realizimin e reklamës televizive promovuese të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë".

Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip

TERMAT E REFERENCËS:

Qëllimi i prodhimit dhe transmetimit të 1 (një) reklame televizive është: promovimi i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë dhe programeve të studimit që ai ofron.

Është informimi i maturanëve të ardhshëm të shkollave të vendit, si dhe për të gjithë studentët që kërkojnë të ndjekin një program të ciklit të dytë dhe të tretë studimesh, me synimin rritjen e numërit të studentëve në programet e studimit që zhvillojnë departamentet dhe fakultetet e UV.

Nevoja për këtë reklamë televizive promovuese: Promovimi i UV, promovimi i programeve të studimit dhe raporti i tyre me tregun e punës me synimin e rritjes së numërit të studentëve të Universitetit Ismail Qemali Vlorë.

Koha e një transmetimi: 2 minuta

Shpeshtësia e transmetimit: 5 (pesë) herë në ditë.

Periudha e transmetimit: Qershor - Dhjetor 2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI

Përshkrimi i imët i reklamës televizive promovuese për UV:

Leximi i tekstit shoqërohet me transmetim pamjesh nga UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI, VLORË: Godinat e fakulteteve, Logot përkatëse, pedagogë në sallë mësimi, laboratore, klasa me student etj.

Teksti:

Të dashur maturan të dhe studentë në përfundim të nivelit Bachelor të studimeve universitare!

Të dashur të interesuar!

- Universiteti "ISMAIL QEMALI", Vlorë - Institucioni i Arsimit të Lartë, në Jug të Shqipërisë, Ju mirëpret në auditorët e tij!
- Universiteti "ISMAIL QEMALI", Vlorë është zgjidhja e dilemave të karrierës Suaj! Mbështetësi i ëndërrave Tuaja profesionale dhe akademike!

I vendosur në qytetin e bukur bregdetar të Vlorës, Ju mirëpret t'i shërbejë vizionit Tuaj:

Universiteti "ISMAIL QEMALI", Vlorë, zhvillon proces mësimor në disa programe studimi profesionale e teknike 1 (një) dhe 2 (dy) vjeçare, në të tre nivelet e studimeve universitare: Bachelor, Master Profesional e Shkencor si dhe studime doktorale në "Studime gjuhësore, letrare e kulturore" dhe në Matematikë

Institucion i Arsimit të Lartë, i akredituar 2 (dy) herë nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me programe studimi Bachelor të Akredituara dhe të tjera Master Profesional e Master shkencor në proces akreditimi!

Programe studimi në Shkenca detare, Inxhinieri elektrike e mekanike, Shkenca kompjuterike, Bilogji e Kimi, Drejtësi, Mësuesi, Komunikim e trashëgimi kulturore, Gjuhë të huaja e Pedagogji të specializuar, disa programe studimi në Infermieri, si dhe programe studimi në fushën ekonomike: Kontabilitet, Financë, Ekonomiks, Administrim, Biznes, Turizëm etj.

Në Universitetin "ISMAIL QEMALI", Vlorë, do të gjeni:

- Një universitet të ndërkombëtarizuar, partner i mbi 60 universiteteve të huaja dhe rreth 140 marrëveshje dypalëshe të ndryshme e të larmishme,
- Proces mësimor modern, bashkëkohor, cilësor dhe rezultativ,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË KOMISIONI

- Tarifat e studimit - më të ulta në tregun universitar të vendit,
- Katër fakultete, katër ndërtesa dhe shumë ambjente moderne shkollimi dhe edukimi,
- Laboratorë bashkëkohorë që mbështesin procesin mësimor e pedagogjik,
- Garanci shkollimi semestral, në universitetet më të spikatura europiane, transferim e përfitim kreditesh, mobilitete dhe eksepriencia të garantuara ndërkombëtare, të financuara nga UV dhe BE.
- Staf akademik cilësor dhe dinjitoz, i përkushtuar në mësimdhënie bashkëkohore,
- Mundësi shkollimi në programe studimi Double Degree me Universitetet e huaja.
- Shërbim, komunikim dhe informacion *dixhital* për çdo student dhe personalitet akademik,
- Mundësi punësimi sezonal gjatë studimeve dhe punësimi pas diplomimit, përmes lidhjeve dhe partneriteteve të UV me Institucionet private e publike të rajonit dhe vendit.
- Veprimtari kulturore, sportive e sociale

Të dashur maturantë! Të dashur të interesuar!

Universiteti "ISMAIL QEMALI", Vlorë - Institucioni i lartë arsimor që garanton: fillimin me sukses të ëndërrave Tuaja, përfitimin e një diplome cilësore dhe nisjen e një rruge profesionale të sigurt!

Vlora e bukur dhe Universiteti "ISMAIL QEMALI", Ju mirëpret!

Të tjera kërkesa: Reklama televizive promovuese duhet të realizohet në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve me kualitet Full HD. Pamjet që do të regjistrohen gjatë periudhës së xhirimeve duhet të jenë ekskluzive dhe të miratuara nga autoritetet drejtuese të UV. Efektet audio dhe efektet muzikore në përmbajtje të materialit përdundimtar duhet të jenë të trajtuar posacerisht për reklamë TV.

Reklama duhet të përmbajë: sloganet kryesore të Institucionit, logon zyrtare të UV dhe website zyrtar të UV.

Materiali i reklamës televizive promovuese të prodhuar duhet të dorëzohet në Formatin HD. Materialet e përshtatura për transmetim duhet të dorëzohen në format VIDEO HD1080/MP4 kopje në DVD/USB.

Data përfundimtare e paraqitjes së kërkesës nga organet e medias: data 19.05.2023, ora 12.00.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI**

SKEMA E KRITEREVE TE VLERËSIMIT:

- a. organi i masmedias/agjencia e specializuar (ndërkombëtar/e, kombëtar/e, vendor/e)
- b. koha e transmetimit
- c. çmimi i ofruar nga organi i masmedias/agjencia e specializuar

Vlerësohet me 30 pikë organi i masmedias/agjencia e specializuar (ndërkombëtar/e, kombëtar/e, vendor/e).

Vlerësohet me 20 pikë koha e transmetimit.

Vlerësohet me 50 pikë çmimi i ofruar nga organi i masmedias/agjencia e specializuar.

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, pa TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim. Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Këtë ftesë për negociata do të publikohet në faqen e internetit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në adresën:

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociatim.

1. Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale
- d) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale,
- e) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- f) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
KOMISIONI**

- g) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi.
Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Kriteret e mësipërme duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit.

2. Licence te Ushtrimit te Aktivitetit
3. Formulari i Ofertës

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik:	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI

<p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë vepër penale</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
KOMISIONI

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Për: [Universitetin Ismail Qemali Vlorë]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i []

Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [];

Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [];

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Transmetimi Dite/12 muaj	Çmimi	Vlera
1	Prodhimi dhe transmetimi i reklames televizive promovuese të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë	sasia	1			
Vlera pa TVSH						
TVSH						
Vlera me TVSH						

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____